



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA

TERMA REFERENCE

Objekti:

“Përmirësimi, dixhitalizimi dhe rikualifikimi i infrastrukturës në stacionin e shitjes së naftës Zharrëz në QASHNG”

HYRJE

Albpetrol sh.a. me fondet e buxhetit të vitit 2024 ka planifikuar të financojë ndërtimin e objektit **“Përmirësimi, digjitalizimi dhe rikualifikimi i infrastrukturës së Stacionit të shitjes së naftës Zharrëz” (kontratë me çelësa në dorë).**

I. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është kërkimi dhe prodhimi i hidrokarbureve, i cili përfshin ciklin e plotë të punimeve sizmike, gjeologjike, mekanike, gjeofizike, kërkimin, nxjerrjen, marketimin e naftës bruto në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Albpetrol sh.a e zhvillon aktivitetin e saj duke administruar dhe operuar pusët e të cilët kanë rëndësi të veçantë për ekonominë e vendit zonat Kuçovë, Patos-Marinëz (Drizë +Goran), Ballsh-Hekal, Amonicë-Gorisht, për vendburimet e gazit në zonën Divjakë-Lushnje, Frakull-Fier, Povelcë-Fier, Finiq-Sarandë, rrjeti i transmetimit të produkteve të naftës dhe të gazit, vendburimin e rërës bituminoze Kasnic-Fier, Uzina Mekanike Kuçovë dhe Uzina Mekanike Patos. Misioni kryesor i Albpetrol sh.a është të shfrytëzojë me efektivitet burimet natyrore, pusët ekzistuese dhe hapjen e të rinjve me kosto sa më të ulët. Gjithashtu monitorimi dhe garantimi i jetëgjatësisë dhe sigurisë së veprave nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe efektiv të tyre, mirëmbajtjes dhe modernizimit të sistemeve të monitorimit është një sfidë që Albpetrol sh.a. ka ndërmarrë veçanërisht vitet e fundit.

Stacioni i shitjes së naftës Zharrëz ndodhet buzë rrugës nacionale Fier – Berat në afërsi të fshatit Zharrëz. Prej vitesh ky stacion, është vendi ku magazinohet prodhimi nga të gjitha njësitë duke qenë kështu një ndër kantieret më të rëndësishëm në aktivitetin e kompanisë. Stacioni i shitjes është mjaft i vjetër dhe megjithëse janë bërë ndërhyrje të herë pas herë gjendja e tij është e amortizuar. Gjithashtu teknologjia është e vjetëruar. Edhe në aspektin mjedisor ka nevojë për ndërhyrje. Ndër mangësitë kryesore përmenden:

- Standartet ambjentale janë jashtë kushteve bazike;
- Mungon siguria perimetrale;
- Mungon monitorimi i çisternave në kohë reale;
- Mungon monitorimi i qarkullimit të naftës;
- Mungon monitorimi i temperaturave të lëngut;
- Kërkohet ndërhyrja imediate me punime civile në membranat mbajtëse të çisternave;
- Kërkohet ndërhyrja imediate në sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit.



II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi, digjitalizimi dhe rikualifikimi i infrastrukturës së Stacionit të shitjes së naftës Zharrëz. Projekti ka të bëjë me rikonceptimin e rrjetit të brendshëm të rrugëve në stacionin e Dekantimit, rritjen e kapaciteteve mbajtëse, zëvendësimin dhe ndërtimin e depozitave (rezervuarëve) të reja së bashku me risistemimin e shesheve përreth tyre, sistemimin dhe grumbullimin e ujërave teknologjike dhe të shiut, sistemi i mbrojtjes nga zjarri, punime elektrike (kabina të reja, rrejtë i ndriçimit etj), punime me ndërtesat civile, rrethimin dhe sigurinë e stacionit të shitjes, linjat dhe impiantet teknologjike etj. Këto punime do të kenë efekt në përmirësimin e situatës mjedisore. Projekti ka si qëllim edhe instalimin dhe konfigurimin e sistemeve të sigurisë të teknologjisë së fundit në stacionin e shitjes së naftës Zharrëz me synim rritjen e nivelit të sigurisë dhe marrjen e masave parandaluese në kohë reale.

Projekti synon rehabilitimin e infrastrukturës së stacionit të Shitjes në Zharrëz, optimizimin e operacioneve të këtij stacioni nëpërmjet digjitalizimit dhe plotësimit të stacionit me sistemet e munguara, si ai i Mbrojtjes nga Zjarri dhe i Mbrojtjes Mjedisore. Objekti do të implementohet në fazat e mëposhtme:

FAZA I – Hartimi i Projektit i Zbatimit

FAZA II – Demontim & Prishje

FAZA III – Ndërtimi

FAZA IV – Implementimi i Sigurisë Perimetrale e Sistemit për Monitorimin e Depozitave

FAZA V – Komisionimi, vlerësimi i konformitetit dhe dokumentacioni final.

Projekti konsiston në:

- Përmirësime të infrastrukturës ndërtimore si rikonceptimin e rrjetit të brendshëm të rrugëve, sistemimi i gardhit perimetral, rikonstrukcioni i godinave administrative, risistemimi i shesheve, sistemimi dhe grumbullimi i ujërave të shiut dhe teknologjikë, rilevim e skarifikim toke.
- Demolimi i rezervuarëve ekzistuese të naftës bruto dhe ndërtimi i 2 rezervuarëve me kapacitet $V=1000m^3$ secili, në të njëjtën pozicion.
- Ndërtimi i stacionit të ri të ngarkimit dhe shkarkimit të autoboteve, si dhe stacionit të pompave.
- Ndërtimi i impiantit të ri të depozitimit të GLN.
- Furnizimi dhe instalimi i një peshore për peshëmatjen e autoboteve në hyrjen e stacionit të shitjes dhe përshtatja me peshoren ekzistuese, në krah të peshores ekzistuese dhe integrimi i tyre në një sistem të vetëm.
- Ndërtimi i argjinaturave apo vaskave të avarive, në të gjithë rezervuarët e depozitimit të hidrokarbureve të ndodhur në stacionin të Zharrëzës.
- Demolimi i separatorit ekzistues dhe instalimi i separatorëve nëntokësorë, gravitacional, metalikë.
- Demolimi i rezervuarëve të ujit teknologjik të dëmtuar dhe ndërtimi i 2 rezervuarëve me kapacitet, $V=100m^3$ secili.
- Demolimi i depozitës kubike të betonit dhe ndërtimi i rezervuarit metalik me kapacitet $V=2000m^3$, si rezervë hidrike për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.
- Instalimi i sistemit të zjarrit me uji dhe shkumë.
- Përshtatja e rezervuarëve ekzistues, instalimi i dhomave të shkumës, instalimit i komponentëve lidhës me sistemin GLN dhe sistemet e monitorimit.
- Sistemet e monitorimit të volumit, temperaturës, prezencës së ujit në depozitë, sistemi SCADA dhe sistemet e sigurisë perimetrale.
- Punime elektrike që përfshin ngritjen e rrjetit perimetral të ndriçimit e përshtatja e rrjetit elektrik me nevojat e reja të stacionit.

III. KËRKESAT PËR PROJEKT ZBATIMIN

Në këtë fazë projektuesi do të hartojë projektin e zbatimit i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

Kontraktori (konsulenti) për hartimin e projektit duhet të kontaktojë me pushtetin vendor dhe komunitetin të zonës për të marrë parasysh propozimet e tyre. Këto propozime do të përcillen paraprakisht pranë Autoritetit Kontraktor dhe më tej do të vijohet me hartimin e projektit.

Konsulenti përgatit projektin përfundimtar, vizatimet e detajuara dhe preventivin përfundimtar. Projekti përfundimtar, specifikimet teknike, preventivi dhe vizatimet duhet të përfshijnë punime të plota civile, detaje arkitekturore, strukturore, mekanike dhe elektrike të projektimit dhe vizatime për të gjithë fazat e punimeve në detaje të mjaftueshme që ndërtimi të mund të kryhet pa qenë e nevojshme për modifikime të mëtejshme ose modifikime të vizatimeve. Projekti duhet të përfshijë specifikimet teknike të të gjithë materialeve dhe proceseve të punës që do të vendosen në vepër.

Legjisllacioni, Standardet dhe Normat në Fazën I janë:

Legjisllacioni Shqiptar:

- Urdhër nr. 184 dt. 05.07.2005, "Për miratimin e kushteve teknike dhe normave të projektimit për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për transportimin, depozitimin

dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

- KTP – Kriteria projektimi për veprat e industrisë mekanike, të pasurimit të mineraleve, depove e stallave.
- KTP – Kriteria projektimi. Llogaritja e konstruksioneve prej çeliku.
- KTP – Kriteria projektimi. Instalimet elektrike në mjediset me rrezik zjarri.
- KTP – Kriteria projektimi. Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike.
- VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësisë e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së Transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore”.
- Ligji Nr. 10440, date 07.07.2011” Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (VNM-së) të ndryshuar.
- VKM Nr. 1066, dt. 23.12.2015 – Për Miratimin e Rregullit Teknik, “Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosferë) potencialisht shpërthyes”.

Standardet e harmonizuar shqiptare:

- S SH EN 14015:2004 - Specifikim për projektimin dhe prodhimin e rezervuarëve prej çeliku, me saldim, të montuar në vendin e instalimit, vertikal, cilindrik, me fund të sheshtë, të destinuar për depozitimin e lëngjeve në temperaturën e ambientit dhe më lart
- S SH EN 288-2 – Specifikimet dhe Aprovimi i procedurave të saldimit për materialet metalike – Pjesa 2: Procedura e saldimit për saldim me shkrirje
- S SH EN 1092-1 – Fllanxhat dhe bashkimet e tyre – Fllanxha rrethore për tuba, valvola, komponentë dhe aksesore, sipas PN – Pjesa 1: Fllanxhat e çelikut
- S SH EN 10025:2004 - Produkte të laminuara në të nxehtë të çelikeve për konstruksionet - Pjesa 1: Kushtet teknike të përgjithshme të livrimit
- S SH EN 10028-2 - Produkte llmarine çeliku për përdorime në presion - Pjesa 2: Çelike të palidhur dhe çelike të lidhur me veti të specifikuara për temperaturë të lartë
- S SH EN 10204:2004 - Produkte metalike - Llojet dhe dokumentet e kontrollit
- S SH EN 10216-1 – Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 1: Tuba çeliku të pa lidhur me karakteristika specifike në temperaturë dhome
- S SH EN 10216-2 – Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 2: Tuba çeliku të pa lidhur dhe të lidhur me karakteristika specifike në temperaturë të lartë
- S SH EN 10216-3 – Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 1: Tuba çeliku të lidhur me strukturë shumë të imët
- S SH EN 12874 - Kapësit e flakës – Kërkesat e performancës, metodat e testimit dhe kushtëzimet në përdorim
- S SH EN 1090-2:2018 - Realizim i konstruksioneve prej çeliku dhe alumini - Pjesa 2: Kërkesa teknike për realizimin e konstruksioneve prej çeliku
- S SH EN 6520-1 - Saldimi dhe proceset që lidhen me të - Klasifikimi i defekteve gjeometrike në materialet metalikë - Pjesa 1: Saldimi me shkrirje
- SSH EN ISO 8501-1 - Përgatitja e shtresave të çelikut përpara aplikimit të bojërave dhe produkteve të ngjashme me to - Vlerësimi vizual i pastërtisë së sipërfaqes - Pjesa 1: Shkallët e ndryshkut dhe përgatitja e ndryshkut nga substratet e çelikut të paveshur pas zhvendosjes tërësore të veshjes së mëparshme.

- S SH ISO 13623 – Industritë e naftës dhe gazit natyror - Sistemet e transportimit me tubacion
- S SH ISO 15649 – Industritë e naftës dhe gazit natyror - Tubacion
- S SH ISO 10474 – Çelik dhe produkte çeliku - Dokumentet e inspektimit
- S SH EN ISO 3183 – Industritë e naftës dhe gazit natyror - Tuba çeliku për sistemet e tubacioneve të transmetimit të gazit dhe naftës
- S SH ISO 14313 – Industria e naftës dhe gazit natyror. Valvolat e tubacioneve
- S SH ISO 15590 – Industritë e naftës dhe gazit natyror – Brylat, rakorderitë dhe fllanxhat për sistemet e transportimit me tubacion
- S SH EN 1092-1 – Fllanxhat dhe bashkimet e tyre – Fllanxha rrethore për tuba, valvola, komponentë dhe aksesore, sipas PN – Pjesa 1: Fllanxhat e çelikut
- S SH EN ISO 15609 - Specifikim dhe kualifikim i procedurave të saldimit për materialet metalike
- S SH EN 6520-1 - Saldimi dhe proceset që lidhen me të - Klasifikimi i defekteve gjeometrike në materialet metalikë - Pjesa 1: Saldimi me shkrirje
- S SH ISO 10684 - Elementë shtrëngues - Veshje të galvanizuara në tretësirë në të nxehtë
- S SH EN 10548-1 - Bashkime me bulona për konstruksione pa parangarkim - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme
- S SH EN ISO 12944 – Bojra dhe llaqe – Mbrojtja nga korrozioni i strukturave të çelikut me anë të sistemeve mbrojtëse të bojërave
- S SH EN ISO 19840 – Bojra dhe llaqe - Mbrojtja nga korrozioni i strukturave të çelikut nga sistemet mbrojtëse të bojës - Matja dhe kriteret e pranimit për trashësinë e filmave të thatë në sipërfaqe të përafërt

Direktivat e harmonizuar europiane:

- Direktiva Europiane 99/92/EC (ATEX 137), që lidhet me kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetin në punë në atmosferat potencialisht shpërthyes.
- Direktiva Europiane 94/9/EC (ATEX 95), që i referohet pajisjeve, mjeteve matëse e mjeteve mbrojtëse të përdorur në atmosferë potencialisht shpërthyes.

Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj së zbatimit të punimeve. Varianti përfundimtar dhe i miratuar i zgjidhjes së planimetrisë i përcaktuar tashmë dhe i fiksuar në harta dixhitale duhet që për këtë fazë të fiksohet edhe në terren nëpërmjet pikave kryesore të rrjetit koordinativ, të cilat duhet të kenë koordinatat dhe kuotat përkatëse. Këto pika do t'i shërbejnë ndërtuesit për piketimin përfundimtar të objekteve në terren.

Raporti përfundimtar i Studimit Gjeologjik/Gjeoteknik & Sizmik

Studimi gjeologjik duhet të jetë i saktësuar duke përfshirë të gjithë dukurinë e saktë gjeomorfologjike të zonës ku shtrihet ky objekt.

Raporti i Studimit Gjeologjik duhet të përpilohet për secilën dukuri fiziko-gjeologjike duke përfshirë dhe materialet e ndërtimit.

Raporti i Studimit Gjeologjik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:

- Fotografi ilustrative të kësaj zone.
- Harta gjeologjike e zonës, material grafik, planimetri, prerje gjeologo-inxhinierike.
- Përcaktimi i vetive fiziko-mekanike të nevojshme për llogaritjen e zgjidhjes përfundimtare të ndërtimit të kësaj vepre.
- Studimin gjeologo-inxhinierik
- Studimi sizmologjik

Projekti Arkitektonik

Projekti arkitektonik, duhet të realizohet duke konsideruar të gjithë strukturat të cilat do të demontohet/prishen dhe duke konsideruar parametrat/distancat e sigurisë të përcaktuar në standardet/normat e aprovuar. Në përputhje me analizën së bazës materialeve, parimeve të projektit dhe evidentimin e objekteve që synojnë prishjen, projekti arkitektonik duhet të përfshijë:

- Planvendosje faktike
- Planimetri Ekzistuese
- Planimetri të përgjithshme që përfshin strukturat e reja dhe linjat teknologjike
- Prerjet e impiantit
- Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara)

Projekti Konstruktiv

Në përputhje me kërkesat e pikës 1.1. “Qëllimi i Projektit”, rezultatet e studimit e projektimit duhet të përfshijnë:

- Projekt për sistemimet civile të të gjithë Stacionit të shitjes që përfshin:
 - Rilevimin, sistemimin e skarifikimin e terrenit për të gjithë stacionin
 - Sistemim e zgjerim të rrugëve ekzistuese edhe realizimin e rrugëve shtesë (rikonceptimi i plotë i rrjetit të brendshëm të rrugëve)
 - Gardhin perimetral,
 - Rikonstruksionin e godinave administrative,
 - Risistemimin e shesheve të estakadës së ngarkimit & stacionit të pompave
 - Rehabilitimin e sheshit brenda perimetrit të argjinaturave të RVM-ve.
 - Rehabilitim të vaskave të separatorëve gravitacionalë.
- Projekt për ndërtimin e argjinaturave apo vaskave të avarive, në të gjithë rezervuarët e stacionit që përmbajnë lëndë të rrezikshme
- Projekt të themeleve për rezervuarin/ët:
 - e reja me kapacitet $V=1000\text{m}^3$ të naftës bruto
 - e ri, metalik me kapacitet $V=2000\text{m}^3$, si rezervë hidrike për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.
 - të ujit teknologjik me kapacitet, $V=100\text{m}^3$ secili (në total 2).
 - Projekt për realizimin e strukturave metalike në:
 - Estakadën e Ngarkimit
 - Stacionin e ri të pompave
 - Impiantin e ri të ngrohjes GLN
 - Strukturat e shkallët metalike të gjuajtësve të shumës
 - Struktura të tjera ndihmëse të papërshkruar më sipër, që lidhen me qëllimin e realizimit të projektit.

- Projekte të tjera konstruktive që lidhen me:
 - Bazamentet e suporteve të linjave teknologjike
 - Punimet civile që lidhen me peshoren shtesë automobilistike dhe përshtatjen e peshores ekzistuese
 - Bazamentet e pompave dhe pajisjeve të tjera që do të instalohen
 - Instalimet elektrike dhe ndriçimin e stacionit të shitjes.
 - Nevoja të tjera të papërshtatshme sipër, që lidhen me qëllimin e realizimit të projektit.
- Detajet Teknike të Projektit të Zbatimit (Relacion Shpjegues).

Raporti përfundimtar i llogaritjeve statike dhe dinamike

Në këtë fazë konsulenti duhet të paraqesë raportin përfundimtar të llogaritjes statike dhe dinamike për objektet që ndodhen brenda sheshit të ndërtimit. Raporti duhet të jetë i detajuar dhe duhet të përmbajë:

Standartin e përdorur për llogaritjet mbi të cilat është hartuar projekti i tyre, ngarkesat, modelimin, rezultatet dhe interpretimin i rezultateve. Raporti duhet të jetë i firmosur nga projektuesi.

Projekti Hidroteknik

Në përputhje me kërkesat e pikës 1.1. “Qëllimi i Projektit”, rezultatet e studimit e projektimit duhet të përfshijnë:

- Projekt sistemit dhe grumbullimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut, përfshirë dhe detajet e pusëve, nyjeve etj.
- Projektin e sistemit dhe grumbullimit të ujërave teknologjike të RVM-ve.
- Relacionin teknik

Projekti Elektrik

Në përputhje me kërkesat e pikës 1.1. “Qëllimi i Projektit”, rezultatet e studimit e projektimit duhet të përfshijnë:

- Projekti i rrjetit perimetral të ndriçimit të stacionit.
- Projekti i përshtatjes e rrjetit elektrik me nevojat e reja të stacionit.
- Projekti i kabinës elektrike
- Relacionin teknik

Projekti i linjave teknologjike

Projekti i linjave teknologjike, duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm për rehabilitimin e stacionit të ngarkimit të naftës bruto, stacionin e pompave, stacionin e ri të parangrohjes së depozitave me GLN, përshtatjen e depozitave ekzistuese edhe lidhjet teknologjike të të gjithë impianteve të sipërpërmendur. Krahas, pjesë e raportit janë dhe linjat teknologjike që lidhen me mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë, si dhe linjat teknologjike të mbetjeve të depozitave.

Relacioni i linjave teknologjike, duhet të përmbajë në detaj:

- Baza materiale, në përputhje me kërkesat e standardeve dhe normave.
- Projekte teknologjike
- Skemat Teknologjike
- Metodologjia e prishjeve dhe ndërtimit në përputhje me normat ATEX

Projekti i Mbrojtjes nga Zjarri & Plani Shpëtimit duhet të përmbajë në detaj:

- Planimetri Teknologjike e sistemit të MNZ.
- Skema Teknologjike e sistemit të MNZ.
- Planimetria e Sinjalistikës së Sigurisë në Punë dhe Emergjencës.
- Projekti i Stacionit të Pompimit të MNZ.
- Projekti i Stacionit të Shkumës.
- Projekti Mekanik i instalimit të gjuajtësve dhe dhomave të shkumës.
- Projekti i detajuar teknologjik i MNZ.
- Relacion Teknik shpjegues për mbrojtjen nga zjarri.
- Plani i Evakuimit dhe Emergjencave.

Projekti i ndërtimit të Rezervuarëve Mbitokësorë

RVM (Rezervuarët mbitokësorë) të parashikuar për tu ndërtuar në Stacionin e Zharrëzës, janë ato të:

- RVM të naftës bruto, me kapacitet $V=1000m^3$, 2 copë, të cilët do të zëvendësojnë 2 rezervuarët aktualë të dëmtuar.
- RVM i rezervës hidrike me kapacitet $V=2000m^3$, i cili do të zëvendësojë depon ekzistuese prej betoni
- RVM të ujërave teknologjike me kapacitet $V=100m^3$, që do të zëvendësojnë depozitat aktuale.

Relacioni i projektit të ndërtimit të tyre, duhet të përmbajë në detaj:

- Baza materiale, në përputhje me kërkesat e standardeve dhe normave.
- Projekte mekanike
- Skemat Teknologjike të lidhjes së tyre me tubacionet.
- Metodologjia e prishjeve dhe ndërtimit në përputhje me normat ATEX

Siguria Perimetrale dhe Sistemi për monitorimin e depozitave (dixhitalizimi)

Projekti ka si qëllim instalimin dhe konfigurimin e sistemeve të sigurisë të teknologjisë së fundit në stacionin e shitjes së naftës Zharrëz me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë dhe marrjen e masave parandaluese në kohë reale.

Objektivat kryesore të këtij projekti janë:

- Rilevim i të gjithë perimetrit të Stacionit të Zharrëzës;
- Rritja e kontrollit dhe sigurisë;
- Monitorimi i çdo qarkullimi të naftës bruto;
- Digjitalizimi i çdo lëvizje apo kontrolli mbi çdo pjese përbërëse të stacionit, duke filluar nga lëvizja e naftës bruto deri tek kontrolli dhe siguria perimetrale;
- Digjitalizim dhe rritje e sigurisë kundra zjarrit apo ndotjes ambientale;
- Standartizimi i të gjithë perimetrit për të shmangur çdo mundësi përhapje të zjarrit.

- Modernizimi i çdo lëvizje brenda stacionit;
- Zëvendësimin e tubacioneve dhe valvulave të cilat ndihmojnë në qarkullimin e fluidit në stacion;
- Digjitalizimi dhe modernizimi i kontrollit mbushjes dhe zbrazjes së kamionëve.
- Raportim në kohë reale i çdo lëvizje apo rrjedhje;
- Kontroll 100% nga një sallë monitoruese për çdo aktivitet.

Siguria Perimetrale

Termi mbrojtje perimetrale nënkupton tërësinë e zgjidhjeve teknologjike, fizike dhe softwarike të sigurisë për siguruar ambientet/asetet nga hyrjet e paautorizuara apo veprimtaritë e tjera keqbërëse me qëllimin përfundimtar të mbrojtjes së jetës dhe pronës. Sigurimi i një mbrojtje maksimale për stacionin e shitjes së naftës Zharrez paraqet një rëndësi të vecantë pasi çdo thyerje e sigurisë mund të sjellë pasoja serioze ku përfshihen:

- ndërprerja e punës, shërbimit,
- dëmtimi i agregateve kryesore të punës,
- vjedhjet e infrastrukturës fizike etj.

Kontraktori në përputhje me realizimit e qëllimit të objektit të prokurimit është përgjegjës për instalimin, vënien në punë dhe konfigurimin i një platforme digjitale me sensorë për monitorimin e depozitave të naftës bruto, ku komponentët minimale që duhet të përfshihen, trajtohen si më poshtë:

Sistemi i Sensoreve

Përfshin sensorët që matin nivelin e naftës, temperaturën, presionin gjithashtu parametrat kimikë si matje të përqendrimit të ujit në fluid. Këta sensorë ndihmojnë në monitorimin e gjendjes së depozitave në kohë reale dhe sigurinë e operacioneve.

Platforma Digjitale

Një sistem i bazuar në softuer që mbledh dhe analizon të dhënat e marra nga sensorët. Platforma mund të përfshijë ndërfaqe vizuale dashboards për vizualizimin e të dhënave, algoritme për parashikimin e problemeve potenciale, dhe mjete për menaxhimin e alarmeve.

Ndërfaqja e përdoruesit

Një ndërfaqe përdoruesi miqësore që lejon operatorët të qasen në të dhëna në kohë reale dhe të marrin vendime të informuara bazuar në të dhënat që vijnë nga sensorët.

Sistemi i Komunikimit dhe Transmetimit të të Dhënave

Përfshin teknologjitë e komunikimit për të dërguar të dhënat nga sensorët në platformën qendrore dixhitale.

Protokollet e Sigurisë dhe Integritetit të të Dhënave

Masat e sigurisë për të mbrojtur të dhënat nga akseset e paautorizuara dhe për të garantuar saktësinë e të dhënave.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

Objekti: **“Përmirësimi, digjitalizimi dhe rikualifikimi i infrastrukturës së Stacionit të shitjes së naftës Zharrëz”**, i nënshtrohet procedurës së vlerësimit paraprak të VNM-së, hartimi i Raportit të VNM-së dhe Relacionit Teknik duhet të bazohet në: Vendimin Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësisë e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së Transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore”. Kështu në fazën I të projektimit, kontraktori duhet të zhvillojë:

- Raportin paraprak të VNM-së, ku duhet të përfshihen
 - a. përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
 - b. informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
 - c. informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
 - d. një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve; (Duhet të identifikohen vend depozitimet për mbetjet e ngurta të autorizuar nga pushteti vendor.)
 - e. informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
 - f. të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
 - g. mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
 - h. masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
 - i. ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).
- Relacionin teknik të projektit të propozuar, ku duhet të përfshihen
 - a. qëllimin e projektit të propozuar;
 - b. planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit shtetëror të miratuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
 - c. informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;
 - d. skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;
 - e. përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
 - f. informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
 - g. programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të

- projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- h. lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
 - i. informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
 - j. informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
 - k. të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
 - l. aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
 - m. informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;
 - n. kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

Në këtë fazë kontraktori është përgjegjës për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe aplikimin për marrjen e “Vendim për VNM Paraprake”, bazuar në ligjin Nr. 10440, date 07.07.2011” PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS” (VNM-së) të ndryshuar, dhe VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” për objektin që do të ndërtohet.

Auditi i Efiçensës së Energjisë në Instalime Industriale

Në fazën I të projektimit, kontraktori duhet të përgatisë dhe raportin teknik të efiçencës së energjisë për impiantin industrial i cili duhet të përmbajë dhe llogaritjet e nevojshme për efiçencën energjitime të impiantit.

Përgatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve për Demontimet e Prishjet

Albpetrol Sh.A. synon të vijojë me aktivitetin e stacionit paralelisht me rehabilitimin e tij. Në këto kushte, të gjithat aktivitete që do të kryhen në stacion, do të realizohen në atmosferë potencialisht shpërthyes, zonë e quajtur ATEX. Në përputhje me direktivën Europiane 99/92/EC (ATEX 137) e harmonizuar sipas VKM Nr. 1066, dt. 23.12.2015 – Për Miratimin e Rregullit Teknik, “Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosferë) potencialisht shpërthyes” dhe Përcaktimin e listës së Standardëve të Harmonizuara – duhet të konsiderohet zhvillimi i metodologjisë së përshtatshme për demontimet e prishjet.

Metodologjia për demontimet dhe prishjet në fazën e projektimit, duhet të përfshijë:

- Kërkesat e direktivës europiane të harmonizuar 99/92/EC (ATEX 137), që lidhet me kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetin në punë në atmosferat potencialisht shpërthyes.
- Kërkesat e direktivës europiane të harmonizuar 94/9/EC (ATEX 95), që i referohet pajisjeve, mjeteve matëse e mjeteve mbrojtëse të përdorur në atmosferë potencialisht shpërthyes.

Në bazë të direktave sipërpërmendur, do të trajtohen të gjithë praktikat e punës, pajisjet e sigurisë dhe mjetet e punës për zhvillimin e aktivitetit të prishjeve. Metodologjia duhet të trajtojë:

- Demontimet e linjave teknologjike, pajisjeve dhe elementeve të lidhur me RVM të naftës bruto dhe të ujit teknologjik.
- Pastrimi i mbetjeve të fundeve të RVM të naftës bruto e ujërave teknologjik, të pusëve të separatoreve dhe mbetjeve të tjera të rrezikshme të shpërndara në stacion.
- Demolimi i strukturave metalike të RVM-ve, pompave, linjave teknologjike e elementeve të tjerë të stacionit sipas pikës 1.1. “Qëllimi i Projektit”, duke konsideruar të gjitha kërkesat për pajisjet dhe mjetet e sigurisë ATEX.
- Prishja e strukturave ndërtimore, të betonit, vaskën ekzistuese të depozitës së MNZ-së.
- Largimi i tyre nga kantieri dhe dorëzimi i tyre në vend-depozitimin e dakordësuar me Albpetrol Sh.a., në një distancë me rreze jo më të largët se 15km nga kantieri i ndërtimit.

Përgatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve për Punimet e Zbatimit

Albpetrol Sh.A. synon të vijojë me aktivitetin e stacionit paralelisht me rehabilitimin e tij. Në këto kushte, të gjithat aktivitete që do të kryhen në stacion, do të realizohen në atmosferë potencialisht shpërthyes, zonë e quajtur ATEX. Në përputhje me direktivën Europiane 99/92/EC (ATEX 137) e harmonizuar sipas VKM Nr. 1066, dt. 23.12.2015 – Për Miratimin e Rregullit Teknik, “Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosferë) potencialisht shpërthyes” dhe Përcaktimin e listës së Standardëve të Harmonizuara – duhet të konsiderohet zhvillimi i metodologjisë së përshtatshme për demontimet e prishjet.

Metodologjia për punimet e zbatimit në fazën e projektimit, duhet të përfshijë:

- Kërkesat e direktivës europiane të harmonizuar 99/92/EC (ATEX 137), që lidhet me kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetin në punë në atmosferat potencialisht shpërthyes.
- Kërkesat e direktivës europiane të harmonizuar 94/9/EC (ATEX 95), që i referohet pajisjeve, mjeteve matëse e mjeteve mbrojtëse të përdorur në atmosferë potencialisht shpërthyes.

Volumet e punës dhe Preventivi

Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit kontraktori (konsulenti) do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi), bazuar në Manualin Teknik të Çmimeve të punimeve të Ndërtimit të vitit 2023.

Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe mënyrën e llogaritjes së tyre.

Përgatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit.

Raporti i projektit të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mësipërm si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.

Për vetë specifikën e këtij projekti Drafti i raportit përfundimtar të projektit të zbatimit do të të paraqitet në formë zyrtare tek Autoritetit Kontraktor për shqyrtim dhe miratim.

Vizatimet

Kontraktori (konsulenti) në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të hartojë vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

1. Planimetri të gjendjes ekzistuese
2. Planimetria e re

Detaje teknike të projekt zbatimit në shkallë të ndryshme.

IV. KËRKESAT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT

Bazë për fazën e ndërtimit të objektit :

“Përmirësimi, digjitalizimi dhe rikualifikimi i infrastrukturës së Stacionit të shitjes së naftës Zharrëz” (kontratë me çelësa në dorë) do të shërbejnë Standartet teknike në fuqi.

Legjislacioni, Standardet dhe Normat në Fazën e Ndërtimit:

Legjislacioni Shqiptar:

- VKM Nr. 1066, dt. 23.12.2015 – Për Miratimin e Rregullit Teknik, “Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosfera) potencialisht shpërthyesë”.
- VKM Nr.312, datë 5.5.2010 për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"
- VKM Nr. 1060, Date 23.12.2015 Per Miratimin e Rregullit Teknik “Për makineritë”
- KTZ – Zbatim punimesh. Kushte të përgjithshme për zbatimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtim – montimit
- KTZ – Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të gërmimit dhe të mbushjes në veprat industriale, qytetare dhe bujqësore.
- KTZ – Zbatim punimesh suvatimi në ndërtesat.
- KTZ – Zbatimi dhe marrja në dorëzim e strukturave prej betoni dhe beton/armeje në veprat hidroteknike.
- KTZ – Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për veshje të faqeve të mureve të brendshme e të jashtme në ndërtesat industriale, qytetare dhe bujqësore.
- KTZ – Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për ndërtimin e rezervuarëve metalik mbitokësorë naftëmbajtës.
- KTZ – Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për termoizolimimin e tubacioneve, paisjeve dhe rezervuarëve.
- KTZ – Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të konstruksioneve metalike.
- KTZ – Kushte teknike të shmangieve të lejuara në ndërtim-montim.
- KTZ – Zbatimi dhe marrja në dorëzim për montimin e pajisjeve hidraulike statike.
- KTZ – Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e tubacioneve të gazsjellësit.

Standardet e harmonizuar shqiptare

- S SH EN 14015:2004 - Specifikim për projektimin dhe prodhimin e rezervuarëve prej çeliku, me saldim, të montuar në vendin e instalimit, vertikal, cilindrik, me fund të sheshtë, të destinuar për depozitimin e lëngjeve në temperaturën e ambientit dhe më lart
- S SH EN 287-1:2004 – Prova e kualifikimit të saldatorëve - Saldimi me shkrirje – Pjesa 1: Çeliquet
- S SH EN 288-2 – Specifikimet dhe Aprovimi i procedurave të saldimit për materialet metalike – Pjesa 2: Procedura e saldimit për saldim me shkrirje
- S SH EN 473 – Testime pa shkatërrim – Prova e kualifikimit të personelit NDT – Parime të përgjithshme
- S SH EN 499 – Të konsumueshmet e saldimit – Elektrodat e mbuluara për saldim manua me hark i çeliqueve jo të lidhura – Klasifikimi
- S SH EN 970 – Ekzaminimi pa shkatërrim i saldimit me hark – Ekzaminimi vizual
- S SH EN 1092-1 – Fllanxhat dhe bashkimet e tyre – Fllanxha rrethore për tuba, valvola, komponentë dhe aksesorë, sipas PN – Pjesa 1: Fllanxhat e çelikut
- S SH EN 10025:2004 - Produkte të laminuara në të nxehtë të çeliqueve për konstruksionet - Pjesa 1: Kushtet teknike të përgjithshme të livrimit
- S SH EN 10028-2 - Produkte llmarine çeliku për përdorime në presion - Pjesa 2: Çelique të palidhur dhe çelique të lidhur me veti të specifikuara për temperaturë të lartë
- S SH EN 10204:2004 - Produkte metalike - Llojet dhe dokumentet e kontrollit
- S SH EN 10216-1 – Tuba çeliku pa tegel saldimit për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 1: Tuba çeliku të pa lidhur me karakteristika specifike në temperaturë dhome
- S SH EN 10216-2 – Tuba çeliku pa tegel saldimit për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 2: Tuba çeliku të pa lidhur dhe të lidhur me karakteristika specifike në temperaturë të lartë
- S SH EN 10216-3 – Tuba çeliku pa tegel saldimit për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 1: Tuba çeliku të lidhur me strukturë shumë të imët
- S SH EN 12874 - Kapësit e flakës – Kërkesat e performancës, metodat e testimi dhe kushtëzimet në përdorim
- S SH EN ISO 3834-2 - Kërkesa të cilësisë për saldim me shkrirje të materialeve metalike - Pjesa 2: Kërkesa të përgjithshme të cilësisë
- S SH EN 1090-2:2018 - Realizim i konstruksioneve prej çeliku dhe alumini - Pjesa 2: Kërkesa teknike për realizimin e konstruksioneve prej çeliku
- S SH EN 10204:2004 – Produktet metalike – Tipet e dokumenteve të inspektimit
- S SH EN 6520-1 - Saldimi dhe proceset që lidhen me të - Klasifikimi i defekteve gjeometrike në materialet metalikë - Pjesa 1: Saldimi me shkrirje
- SSH EN ISO 8501-1 - Përgatitja e shtresave të çelikut përpara aplikimit të bojërave dhe produkteve të ngjashme me to - Vlerësimi vizual i pastërtisë së sipërfaqes - Pjesa 1: Shkallët e ndryshkut dhe përgatitja e ndryshkut nga substratet e çelikut të paveshur pas zhvendosjes tërësore të veshjes së mëparshme
- S SH ISO 10684 - Elementë shtrëngues - Veshje të galvanizuara në tretësirë në të nxehtë
- S SH EN 10548-1 - Bashkime me bulona për konstruksione pa parangarkim - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme

- S SH EN 287-1:2004 – Prova e kualifikimit të saldatorëve - Saldimi me shkrirje – Pjesa 1: Çeliquet
- S SH EN 288-2 – Specifikimet dhe Aprovimi i procedurave të saldimit për materialet metalike – Pjesa 2: Procedura e saldimit për saldim me shkrirje
- S SH EN 473 – Testime pa shkatërrim – Prova e kualifikimit të personelit NDT – Parime të përgjithshme
- S SH EN 499 – Të konsumueshmet e saldimit – Elektrodat e mbuluara për saldim manua me hark i çeliqueve jo të lidhura – Klasifikimi
- S SH EN 970 – Ekzaminimi pa shkatërrim i saldim me hark – Ekzaminimi vizual
- S SH EN 1092-1 – Fllanxhat dhe bashkimet e tyre – Fllanxha rrethore për tuba, valvola, komponentë dhe aksesorë, sipas PN – Pjesa 1: Fllanxhat e çelikut
- S SH EN 10025:2004 - Produkte të laminuara në të nxehtë të çeliqueve për konstruksionet - Pjesa 1: Kushtet teknike të përgjithshme të livrimit
- S SH EN 10028-2 - Produkte llmarine çeliku për përdorime në presion - Pjesa 2: Çelique të palidhur dhe çelique të lidhur me veti të specifikuara për temperaturë të lartë
- S SH EN 10204:2004 - Produkte metalike - Llojet dhe dokumentet e kontrollit
- S SH EN 10216-1 – Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 1: Tuba çeliku të pa lidhur me karakteristika specifike në temperaturë dhome
- S SH EN 10216-2 – Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 2: Tuba çeliku të pa lidhur dhe të lidhur me karakteristika specifike në temperaturë të lartë
- S SH EN ISO 8501-1 – Përgatitja e shtresave të çelikut përpara aplikimit të bojërave dhe produkteve të ngjashme me to - Vlerësimi vizual i pastërtisë së sipërfaqes - Pjesa 1: Shkallët e ndryshkut dhe përgatitja e ndryshkut nga substratet e çelikut të paveshur pas zhvendosjes tërësore të veshjes së mëparshme
- S SH EN ISO 8501-3 – Përgatitja e substrateve të çelikut para aplikimit të bojërave dhe produkteve të lidhura me to - Vlerësimi vizual i pastërtisë së sipërfaqes - Pjesa 3: Gradët e përgatitjes së bashkimit, kufijtë dhe zonat e tjera me të meta sipërfaqësore
- S SH EN ISO 12944 – Bojra dhe llaqe – Mbrojtja nga korrozioni i strukturave të çelikut me anë të sistemeve mbrojtëse të bojërave
- S SH EN ISO 19840 – Bojra dhe llaqe - Mbrojtja nga korrozioni i strukturave të çelikut nga sistemet mbrojtëse të bojës - Matja dhe kriteret e pranimit për trashësinë e filmave të thatë në sipërfaqe të përafërt
- S SH ISO 13623 – Industrinë e naftës dhe gazit natyror - Sistemet e transportimit me tubacion
- S SH ISO 15649 – Industrinë e naftës dhe gazit natyror - Tubacion
- S SH ISO 10474 – Çelik dhe produkte çeliku - Dokumentet e inspektimit
- S SH EN ISO 3183 – Industrinë e naftës dhe gazit natyror - Tuba çeliku për sistemet e tubacioneve të transportimit të gazit dhe naftës
- S SH ISO 14313 – Industria e naftës dhe gazit natyror. Valvolat e tubacioneve
- S SH ISO 15590 – Industrinë e naftës dhe gazit natyror – Brylat, rakorderitë dhe fllanxhat për sistemet e transportimit me tubacion
- S SH ISO 13847 - Industrinë e naftës dhe gazit natyror – Saldimi i tubacioneve
- S SH EN 1092-1 – Fllanxhat dhe bashkimet e tyre – Fllanxha rrethore për tuba, valvola, komponentë dhe aksesorë, sipas PN – Pjesa 1: Fllanxhat e çelikut

- S SH EN 10025:2004 - Produkte të laminuara në të nxehtë të çeliqueve për konstruksionet - Pjesa 1: Kushtet teknike të përgjithshme të livrimit
- S SH EN 10028-2 - Produkte llamarine çeliku për përdorime në presion - Pjesa 2: Çelique të palidhur dhe çelique të lidhur me veti të specifikuara për temperaturë të lartë
- S SH EN 10204:2004 - Produkte metalike - Llojet dhe dokumentet e kontrollit
- S SH EN 10216-1 – Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 1: Tuba çeliku të pa lidhur me karakteristika specifike në temperaturë dhome
- S SH EN 10216-2 – Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 2: Tuba çeliku të pa lidhur dhe të lidhur me karakteristika specifike në temperaturë të lartë
- S SH EN 10216-3 – Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion - Kushtet teknike të shpërndarjes - Pjesa 1: Tuba çeliku të lidhur me strukturë shumë të imët
- S SH EN 6520-1 - Saldimi dhe proceset që lidhen me të - Klasifikimi i defekteve gjeometrike në materialet metalikë - Pjesa 1: Saldimi me shkrirje
- S SH EN ISO 12944 – Bojra dhe llaqe – Mbrojtja nga korrozioni i strukturave të çelikut me anë të sistemeve mbrojtëse të bojërave
- S SH EN ISO 19840 – Bojra dhe llaqe - Mbrojtja nga korrozioni i strukturave të çelikut nga sistemet mbrojtëse të bojës - Matja dhe kriteret e pranimit për trashësinë e filmave të thatë në sipërfaqe të përafërt

Direktivat e harmonizuar europiane:

- Direktiva Europiane 99/92/EC (ATEX 137), që lidhet me kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetin në punë në atmosferat potencialisht shpërthyes.
- Direktiva Europiane 94/9/EC (ATEX 95), që i referohet pajisjeve, mjeteve matëse e mjeteve mbrojtëse të përdorur në atmosferë potencialisht shpërthyes.

Për fazën e ndërtimit kontraktori (konsulenti) duhet të pajiset me lejet si më poshtë:

- Përcaktimi i venddepozitimit të inerteve nga Njësi e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV).
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për aplikimin e Lejes së Infrastrukturës bazuar në ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015.

FAZAT, AFATET DHE MIRATIMET

Fazat

Fazat e parashikuara dhe afatet orientuese për ndërtimin e objektit janë:

Projekti

Projekti i zbatimit	3 muaj nga data e lidhjes së kontratës
Oponenca teknike	1 muaj
Miratimi në AK	15 ditë

Organizimi i Kantjerit

Ndërtimi sipas projektit	12 muaj
Monitorimi dhe garancia e difekteve	24 muaj

Të gjitha fazat do të kontrollohen dhe miratohen nga AK.

Kontraktori në fund të çdo faze duhet të paraqesë këto raporte :

Raportet e projektimit (të detajuar sipas proceseve)

Raport të detajuar të ecurisë së punimeve.

Raportin teknik (të detajuar sipas proceseve, topografik , gjeologjik etj)

Afatet

Kontraktori (Konsulenti) duhet të përcaktojë me detaje sipas fazave të parashikuara afatet kohore të realizimit të punimeve. Afatet e dhëna në tabelën më sipër janë vetëm orientuese. Afatet do të jenë funksion i metodologjisë së ndërtimit dhe organizimit të brendshëm të kontraktorit (konsulentit). Në çdo rast afatet e dhëna nga kontraktori (konsulenti) duhet të jenë të arsyetuara dhe të shoqëruara me shpjegimet e përdorimit, ciklit të punës së makinerive, fuqisë punëtore.